



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 188/ 2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur, përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur ndaj militantëve të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për shkak të ndikimit tek votuesit, gjatë procesit të zgjedhjeve në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 21.06. 2012, mori këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 18.06.2012, nga subjekti politik LVV, dega në Kaçanik, me të cilën pretendohet se me datën 17.06.2012 në fshatin Biqec në oborrin e shkollës fillore "Jusuf Gërvalla" në QV 0705D rreth orës 11:00, kanë qëndruar Azem Guri drejtor i arsimit në kuvendin komunal të Kaçanikut, Hajrush Dullovi dhe Besim Sallahu të dy zyrtar të kuvendit komunal të Kaçanikut dhe të cilët po bëjnë presion tek qytetarët duke ju thënë se për kë të votojnë. Parashtruesi i ankesës thekson se kjo përbënë shkelje të Kodit të Mirësjelljes dhe shkelje të nenit 177 të KPK-së.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 18.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik nga ana e LVV-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.06.2012, në ora 15:00.

PZAP-i, me datën 19.06.2012, mori përgjigjen e kërkuar nga PDK në të cilën theksohet se Azem Guri ka sjell në QV motrën e tij për votim, ndërsa derisa motra e tij ka kryer votimin ai është shoqëruar nga Hajrush Dullovi dhe Besim Sallahu me të cilët është takuar në rrugë, por vendi në të cilin janë takuar është në largësi mbi 100 m nga QV-ja, prandaj me të përfunduar votimin motra e Azem Gurit ai e kthen prapë në shtëpi motrën e tij.

PZAP-i me datën 20.12.2012 po ashtu kërkoi një deklaratë përmes audio incizimit nga Burim Bunjaku menaxher i QV 0705D, lidhur me ankesën e parashtruar nga LVV.

Në deklaratën e tij të dhënë PZAP-it, përmes audio incizimit nga Burim Bunjaku menaxheri QV 0705D mohohen pretendimet e tilla ankimore të parashtruara në ankesë duke theksuar Hajrush Dullovi ka ardhur për te votuar pasi që ky është nga ky fshat, ndërsa Azem Guri ka sjellë motrën e tij të vjetër për te votuar në këtë QV, pasi që ajo këtu ka qenë e caktuar për të votuar, për të gjitha këto ekzistojnë edhe raportet policore te cilat kanë qëndruar në këtë QV dhe të cilët konfirmojnë se nuk ka pasur ndonjë problem apo parregullsi, ndërsa nuk është e vërtetë se ka pasur parregullsi brenda hapësirës prej 100 metra nga QV-ja.

Me datën 19.06.2012 PZAP-i kërkoi nga Policia e Kosovës që të ndërmar masa hetimore për rastin në fjalë.

Në raportin e policisë të datës 19.06.2012 theksohet se gjatë ditës së zgjedhjeve gjatë gjithë kohës policia kanë qëndruar në këtë QV0705D dhe kanë kontaktuar menaxherin e QV-së Burim Bunjaku i cili asnjëherë nuk ka kërkuar ndihmën e policisë për ndonjë problem me simpatizantët e ndonjë parti politike apo ndonjë problem brenda për brenda objektit të shkollës. Andaj në perimetrin ku kanë qenë të caktuar për të vepruar gjithçka ka qenë në rregull.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

#### **Ankesa është e pabazuar.**

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për ti vërtetuar pretendimet ankimore, kjo vërtetohet edhe përmes raportit të policisë të datës 19.06.2012, në të cilën theksohet se gjatë kohës sa kanë qëndruar pjesëtarët e policisë së Kosovës në QV e sipërhënuar nuk është raportuar për ndonjë person që ka penguar procesin e votimit si dhe nuk ka pasur ndonjë parregullsi tjetër, kjo vërtetohet edhe nga deklarata e menaxherit të kësaj QV Burim Bunjaku dhënë PZAP-it përmes audio incizimit i cili po ashtu mohon në mënyrë kategorike për parregullsitë e pretenduara nga pala ankuese, andaj pretendimet e tilla ankimore janë si të pabazuara dhe të pa argumentuar në prova dhe dëshmi bindëse, andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 188/2012 më datën 21.06.2012.

**Kryesuesi i panelit  
Ymer Hoxha**

